



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit i rekomanduar për përmirësimin e sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/Luftimin e Financimit të Terrorizmit (efektiviteti) si dhe Shtojca 1 (pjesa teknike), Shtojca 2 (Udhëzues për zbatimin e mjetit për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit), Shtojca 3 (Mjet për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga raporti i vlerësimit).
2. Njësia për Intelgjencë Financiare e Republikës së Kosovës caktohet të bëjë monitorimin e duhur të zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me rrethanat siç kërkohet sipas nenit 14 të Ligjit nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
3. Krijohet grupi i punës me pjesëmarrje të institucioneve të listuara në shtojcë të këtij vendimi, për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioritetëve afatgjata dhe afatshkurtra.
4. Obligohen institucionet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- NJIF-K
- Arkivit të Qeverisë